



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja / Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

	REPUBLIKA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE, ŠUMARSTVA I RURALNOG RAZVOJA MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT Arkivi Qendror - Centralno Arhivsko - Central Archive
Nr./Br./No.	1195
Nr. i fq./Br. Str./No. pg	8
Data/Datum/Date:	18.03.2024
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA	

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 07/2024¹
PËR SISTEMIN INFORMATIV PËR PYJET E KOSOVËS

¹Udhëzim Administrativ (MBPZHR) - NR. 07/2024 Për Shfrytëzimin, Lejet, Sistemin informativ për pyjet e Kosovës, i nënshkuar nga Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me datë 18.03.2024.

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 24, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 08/L- 137 për Pyjet (Gazeta Zyrtare, Nr. 9/ 3 Prill 2023), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.34/18 Nëntor 2022), si dhe nenin 38 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë, Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare Nr. 15, 12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 07 /2024 PËR SISTEMIN INFORMATIV PËR PYJET E KOSOVËS

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimit Administrativ për Sistemi Informativ për Pyjet të Kosovës është vendosja dhe ndërlidhja në mënyrë elektronike e të gjitha të dhënave ekzistuese dhe rrjedhës së informacionit për pyjet, tokat pyjore, mbrojtjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin si dhe të dhëna tjera të nevojshme për të mbështetur zbatimin e objektivave të Ligjit për Pyje.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të obligueshme për të gjitha institucionet shtetërore dhe njësitë e tyre përkatëse në nivel qendror dhe lokal, personat fizik dhe juridik që janë të përfshirë në aktivitetet e të dhënave dhe informatave pyjore.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime:

- 1.1. **Agjencia** - nënkupton Agjencinë Pyjore të Kosovës;
- 1.2. **Informacion pyjor** - nënkupton çdo informatë të shkruar, vizuale, gojore, elektronike ose ndonjë material tjetër në lidhje me gjendjen e pyjeve, masat, raportet, analizat si dhe gjendja e shëndetit të pyjeve;
- 1.3. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përkatëse për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural;
- 1.4. **Ndërveprimi** - nënkupton aftësinë e sistemeve të informacionit, komunikimit, dhe proceseve për të mbështetur dhe mundësuar rrjedhën e të dhënave dhe informatave;
- 1.5. **Portali i Internetit i Sistemit Informativ për Pyjet e Kosovës** - nënkupton një faqe interneti përmes së cilës institucionet përgjegjëse qeveritare, institucionet tjera publike, komunat, operatorët, pronarët dhe shfrytëzuesit e pyjeve, publiku dhe personat të tjerë të përfshirë në aktivitete pyjore që iu ofrohet qasje, dhe/ose iu mundësohet futja e të dhënave dhe informatave për pyje;

- 1.6. **Programi** - nënkupton strukturën organizative për administrim të Sistemit Informativ për Pyjet e Kosovës;
- 1.7. **Publiku** - nënkupton një ose më shumë persona fizik dhe juridik, shoqatat e tyre organizatat, apo grupimet;
- 1.8. **Pyjet publike** – nënkupton pyjet dhe tokat pyjore në pronësi shtetërore;
- 1.9. **Pyjet private** - nënkupton pyjet dhe tokat pyjore në pronësi të personit fizik apo juridik;
- 1.10. **RREIV** - nënkupton Rrjetin Evropian për Informim dhe Vëzhgim.
- 1.11. **SIPK** - nënkupton Sistemit Informativ për Pyjet e Kosovës;
- 1.12. **Toka pyjore** - nënkupton tokat pyjore ose tokat tjera me drunj, janë tokat e mbuluara me drunj pyjor në formë të grumbullit pyjor ose drunjve individualë më të lartë se pesë (5) metër në fazën e tyre të pjekurisë, në kombinim me sipërfaqet e tokave të zhveshura ose me shkurre, me një hapësirë më të madhe se 0.50 ha dhe mbulueshmëri me drunj baras apo më shumë se 10%, që mund të shërbejë për prodhime shtesë, si dhe për ofrimin e funksioneve pyjore ekologjike dhe sociale. Pjesë e tokës pyjore është toka e përshtatshme për shfrytëzim pyjor, siç është toka e zhveshur dhe shkurre pa drunj pyjor, apo e mbuluar me drunj pyjor me sipërfaqe nën 10%, si dhe me sipërfaqe më të madhe se 0.50 ha, nëse ky lloj i tokës krijohet natyrshëm ose është e përshtatshme për vendosjen ose rivendosjen e pyjeve, dhe e përfshirë në planet përkatëse të pyllëzimit dhe dokumentet e planifikimit hapësinor.

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin e njëjtë ashtu siç përcaktohet në Ligjin Për Pyjet, Ligjin për Komunikime Elektronike dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 4

Përmbajtja dhe funksionimi i SIPK

- 1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton përmbajtjen dhe mënyrën e udhëheqjes së SIPK, metodologjinë, strukturën, bazat e përbashkëta, kategoritë dhe nivelet e grumbullimit të të dhënave, si dhe përmbajtjen e informacionit me të cilin informohet publiku dhe institucionet relevante.
- 2. SIPK funksionon si mjet i teknologjisë informative për Agjencinë për të përdorë në mënyrë efektive të dhënat dhe informatat për realizimin e mandatit të tyre për menaxhimin e pyjeve.
- 3. SIPK bënë mbledhjen, klasifikimin, mirëmbajtjen, prezantimin dhe shpërndarjen e të dhënave numerike, përshkruese dhe hapësinore për cilësinë e raportimeve për pyjet, përcjelljen e gjendjes së pyjeve, masat ligjore, administrative, organizative dhe strategjike, informatat shkencore-teknologjike për masat e planifikuara për parandalimin e dëmtimit të pyjeve.
- 4. SIPK mundëson qasje dhe ndërlidhje në informata të sistemeve tjera informative dhe harmonizon të gjitha informatat relevante pyjore në nivel të Kosovës dhe në nivelin ndërkombëtar.
- 5. SIPK bënë mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit dhe të dhënave që janë përpunuar dhe analizuar në përputhje me metodologjitë ndërkombëtare dhe evropiane, përkatësisht mundëson shkëmbimin e të dhënave për pyje me sistemet ekzistuese të ngjashme në nivel ndërkombëtar, në Bashkimin Evropian dhe Shteteve Anëtare, të ndërlidhura me Rrjetin Evropian për Informim dhe Vëzhgimit (RREIV).

6. Treguesit pyjor për të cilët mblidhen të dhënat për SIPK janë të përcaktuara me Ligjin për Pyje, dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5 **Vendosja dhe Struktura e SIPK**

1. SIPK sipas procedurave qeveritare vendoset në serverët e Agjencisë për Shoqëri të Informacionit dhe duhet të jetë i qasshëm nëpërmjet një ueb faqeje të vetme.

2. Administrimi, përdorimi dhe qasja në SIPK përcaktohet sipas Manualit për Administrimin e SIPK.

3. SIPK do të pasqyrojë dhe të shoqërojë Organogramin në kuadër të së cilit punon Agjencia, dhe do të jetë një sistem që ka një bazë qendrore të të dhënave në Agjenci.

4. Struktura e SIPK duhet të jetë i bazuar në këto module themelore:

4.1. Moduli për menaxhimin e pyjeve;

4.2. Moduli për menaxhim me dokumente dhe përkrahje administrative;

4.3. Moduli për monitorim dhe vlerësim;

4.4. Moduli për paraqitje dhe manipulim të gjitha të dhënave me GIS;

4.5. Moduli për integritet me sisteme të tjera informative;

4.6. Moduli për çështje ligjore;

4.7. Moduli për kafshë të egra;

4.8. Moduli i inspektimit;

4.9. Moduli për pronarë të pyjeve private dhe publikun.

5. Modulet themelore të përcaktuara në paragrafin 4 të këtij neni, janë të organizuara në seksione tematike dhe nën seksione që do të përmbajnë edhe të dhënat e ndara sipas gjinisë për temat relevante.

6. Skema e SIPK sipas seksioneve tematike dhe nën-seksioneve është përcaktuar me manualin e përdorimit për SIPK të aprovuar prej Agjencisë Pyjore të Kosovës.

7. Procedurat e punës dhe llogaritjes së të dhënave, mënyra dhe afatet për dorëzimin e të dhënave, informatave dhe raporteve të duhura në SIPK, përcaktohet në bazë të manualit për SIPK.

Neni 6 **Metodologjia e mbledhjes së të dhënave dhe Informatave për SIPK**

1. Të dhënat dhe informatat për gjendjen e pyjeve janë të ndërlidhura me bazat elektronike të të dhënave të sesioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse.

2. Të dhënat dhe informatat për nevojat e SIPK dorëzohen dhe gjenerohen në formë elektronike.

3. Transferimi i të dhënave në formë elektronike sipas këtij udhëzimi administrativ nuk përjashton ofrimin e të dhënave në formën dhe mënyrën e përcaktuar sipas Ligjit për Pyje dhe legjislacionit në fuqi.

4. Metodologjia e mbledhjes, përpunimit dhe llogaritjes së të dhënave, mënyra dhe afatet për dorëzimin e të dhënave, informatave dhe raporteve të duhura në SIPK, përcaktohet në bazë të manualit për SIPK.

Neni 7

Dizajnimi, administrimi dhe mirëmbajtja e SIPK

1. Për dizajnim, administrim dhe mirëmbajtje të SIPK, Agjencia:

1.1. Krijon njësinë për administrimin e SIPK në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës;

1.2. Identifikon, zhvillon dhe mirëmban listën e treguesve pyjor;

1.3. Ofron rekomandime për harmonizimin e SIPK me sistemet e informimit të sesioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse;

1.4. Propozon masa për harmonizimin dhe përfshirjen e SIPK në sistemet ndërkombëtare dhe evropiane për informacionet pyjore.

1.5. Ofron propozime për pajisjet teknologjisë informative dhe pajisje tjera të komunikimit të nevojshme për SIPK;

1.6. Monitoron dhe ofron rekomandime për qasje në të dhënat dhe informatat për pyje.

2. Agjencia siguron shkëmbim të besueshëm dhe të sigurt të të dhënave dhe informatave në formë elektronike, dhe qasje të vazhdueshme në të dhënat dhe informatat nëpërmjet portalit të internetit të SIPK.

Neni 8

Plan programi për administrimin e SIPK

1. Plan programi për administrimin e SIPK përmban:

1.1. Objektivat, përgjegjësitë dhe kërkesat për mirëmbajtjen e tij;

1.2. listën e institucioneve që obligohen për dhënie të informatave dhe mënyrën e dorëzimit të tyre sipas seksioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse;

1.3. mënyra dhe afatet kohore për dorëzimin e të dhënave dhe informatave për pyje;

1.4. mënyrën e shfrytëzimit të të dhënave dhe informatave për pyje;

1.5. vlerësimi i burimeve të nevojshme për zhvillim, zgjerim, avancim dhe mirëmbajtje;

1.6. kërkesat dhe veprimet për plotësim të seksioneve tematike dhe nën-seksioneve përkatëse.

2. Plan programi hartohet nga Agjencia, miratohet nga Ministria dhe publikohet në ueb faqen e Ministrisë.

Neni 9 Të dhënat dhe informatat

1. Personat e autorizuar, me përgjegjësi të caktuara nga administratorët sigurojnë mbledhjen e të dhënave dhe informatave, verifikimin dhe sigurimin e cilësisë së të dhënave, si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe ndërveprimin e sistemit të informimit apo nënsistemit.
2. Administratorët detyrohen për të siguruar qasje të lehtë për shfrytëzuesit dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre gjatë përdorimit të SIPK.
3. Zyrtarët përgjegjës për vendosjen e të dhënave në SIPK sigurojnë për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave dhe informatave për të cilat ata janë përgjegjës.
4. Agjencia mban përgjegjësi për përcaktimin e nivelit të disponueshmërisë së të dhënave dhe informatave sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10 Moszbatimi

Moszbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ, sanksionohet me ndëshkimet e përcaktuara me nenit 75 të Ligjit Nr. 08/L – 173 Për Pyjet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 9/3 Prill 2023).

Neni 11 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas Publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Faton PEÇI

18 / 03 2024